

ÇDO GJË QË DESHËT TË DINI PËR ZGJEDHJET



ÇDO GJË QË DESHËT TË DINI PËR ZGJEDHJET

INFORMATA ELEMENTARE PËR ZGJEDHJET, PARREGULLSITË ZGJEDHORE
DHE ASPEKTE TJERA TË PROCESEVE ZGJEDHORE

PËRMBAJTJE

3 Hyrje

4 Çfarë nënkupton materiali zgjedhor?

5 Çfarë duhet të dimë për fletëvotimin?

6 Çdo gjë që duhet të dini për Listën e Votuesve

8 Çfarë është administratë zgjedhore

10 Çfarë është fushatë zgjedhore

11 Cilat janë autorizimet e Presidentit të Republikës

12 Çfarë është heshtje zgjedhore

14 Çfarë është keqpërdorimi i pozitës zyrtare gjatë zgjedhjeve

15 Çfarë është keqpërdorimi i resurseve publike për qëllime zgjedhore

16 Kërcënime dhe presione

17 Ryshfetin e votuesve e paguajnë vetë votuesit

18 Përgjegjësia e mediave gjatë zgjedhjeve

20 KSHZ e publikoi programin për edukim dhe informim të votuesve

22 Vizioni dhe misioni i CIVILit

IMPRESUM

Boton: CIVIL - Qendra për Liri

Për Botuesin: Xhabir M. Deralla

Këtë publikim e përgatiti Ekipi koordinues i CIVIL - Qendrës për Liri dhe Redaksia CIVIL Media

Redaktor: Igor K. Ilievski

Redaksia: Biljana Jordanovska, Maja Ivanovska, Dijana Tahiri, Angella Petrovska, Dehran

Muratov, Xhabir M. Deralla

Punimi grafik: Arian Mehmeti

Tirazhi: 200 kopje

Gjetjet dhe qëndrimet e prezantuara në këtë publikim janë vetëm të autoreve dhe autorëve dhe nuk i reflektojnë patjetër ato të donatorit.

Kontakte: +389 2 520 91 76 | civil@civil.org.mk

Platforma mediale e CIVILit:

www.civilmedia.mk, www.drejt.mk, www.civil.today, www.civil.org.mk

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

ISBN-10	608-4815-26-X
ISBN-13	978-608-4815-26-6
EAN	9786084815266

Hyrje

Me qëllim të kontributit ndaj forcimit të vetëdijes publike për të drejtën e votimit, si dhe për parregullsitë në proceset zgjedhore, Civili publikoi një varg tekstesh edukative për aspektet e ndryshme të proceseve zgjedhore. Ky publikim është përzgjedhje e këtyre teksteve dhe paraqet vazhdim i kësaj iniciative të ekipit të Civilit.

Shpresojmë se me këtë publikim do të kontribuojmë për edukimin qytetar për të drejtën e votimit dhe proceset zgjedhore në përgjithësi, dhe posaçërisht e rekomandojmë për të gjithë bashkëpunëtorët, anëtarët, mbështetësit, gazetarë/ët qytetarë dhe vëzhguese/it e Civilit.

Njëkohësisht, përkujtojmë:

Qytetaret dhe qytetarët që kanë informata për shkelje të së drejtës për votë, keqpërdorime, presione dhe parregullsi tjera gjatë procesit zgjedhor, mund të paraqesin në ueb faqen www.zgjedhjetelira.info ose të kontaktojnë me Civilin në monitoring.civil@gmail.com, në inboks në [www.facebook/civil.mk](https://www.facebook.com/civil.mk) ose të paraqiten në 02/520 91 76.

Ju dëshirojmë punë të mbarë dhe zgjedhje të lira!

Redaksia CIVIL Media

Çfarë nënkupton materiali zgjedhor?

Materiali zgjedhor për zbatimin e zgjedhjeve përmban: kuti për votime dhe paravane, formularë të transkriptove dhe ditar për punë të bordit zgjedhor, bllok me fletëvotime sipas regjistrit nga Lista e Votuesve, listat e kandidatëve, regjistri i nënshkruar nga Lista e Votuesve, mjete për shënim të personave që kanë votuar (spërkatës dhe UV llambë), shpuzë grafiti, vula, udhëzim për votim dhe material tjetër i nevojshëm për votim.

Sipas rregullave nga Kodi Zgjedhor, udhëzimi për votim vendoset në vend të dukshëm në paravanin votues dhe në vende tjera të dukshme në vendvotimet në pajtim me Udhëzimin nga Komisioni Shtetëror Zgjedhor. Udhëzimi është i shtypur në gjuhën maqedonase dhe shkrim cirilik dhe shkrimet e bashkësive të numëruara në Preambulën e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Materiali zgjedho dorëzohet nga Komisioni Shtetëror Zgjedhor te komisionet komunale zgjedhore, më së voni 72 orë para ditës së caktuar për mbajtjen e zgjedhjeve. Materialin zgjedhor në përfaqësitë diplomatike konsullore e dorëzon në Ministrinë për punë të jashtme person i autorizuar, më së voni pesë ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve.

Sipas Kodit Zgjedhor, gjatë dorëzimit të materialit zgjedhor përpilohet procesverbal në të cilin duhet veçanërisht të shënohet numri total i fletëvotimeve me numrat serik dhe numrin e nevojshëm të listave të kandidatëve që vendosen në ambientet e votimit, si dhe materiale tjera të nevojshme për votim. Procesverbalin e nënshkruajnë kryetari dhe anëtarët e këshillit zgjedhor dhe anëtari i komisionit komunal zgjedhor i cili e dorëzon materialin. Nëse përfaqësuesit prezentë të dorëzuesve të listave kanë vërejtje për dorëzimin e materialit zgjedhor, ata kanë të drejtë t'u mundësohet të evidentohen në procesverbalin dhe të jenë bazë në procedurën për mbrojtje të së drejtës votuese. Gjatë dorëzimit të materialit zgjedhor, të drejtë prezence kanë edhe vëzhguesit e akredituar.

A. Petrovska

Çfarë duhet të dimë për fletëvotimin?

Fletëvotimi e ka rolin më të rëndësishëm në materialin zgjedhor. Kjo u mundëson qytetarëve ta plotësojnë të drejtën e tyre votuese dhe të zgjedhin lirë.

Fletëvotimi ka pesë variante: në gjuhën maqedonase, maqedonase dhe shqipe, maqedonase dhe turke, maqedonase, rome dhe shqipe, maqedonase, shqipe dhe serbe, varësisht nga komunat në të cilat jetojnë qytetarë të bashkësive të ndryshme etnike. Përkaj kësaj, do të përdoret edhe shabllon me alfabetin Braille për personat me vizion të dëmtuar.

Në fletëvotimin ka numër rendor, emri dhe mbiemri i kandidatit që e propozon kandidatin dhe simbol partiak nëse kandidati është i propozuar nga partia. Në anën e kundërt të fletëvotimit ka element giosh, që nuk mund të kopjohet ose skanohet.

Fletëvotimi ka elemente të dukshme dhe të padukshme, të cilat shërbejnë për mbrojtje. Ka fije në dy ngjyra – të dukshme, dhe dy fije të ndryshme dhe të padukshme, të dukshme vetëm nën UV llambë. Kompania që e bën shtypjen e fletëvotimeve propozon një element të fshehtë dhe të padukshëm, e gjithashtu edhe kryetari i Komisionit propozon një, të cilin e di vetëm ai.

Për një votues ka vetëm nga një fletëvotim.

Në koçanin e fletëvotimeve ka numërim, flamur, komuna dhe vendvotim.

Gjatë dorëzimit të materialit zgjedhor përpilohet procesverbal në të cilin duhet të shkruhet numri total i fletëvotimeve me numrat serik dhe numri i nevojshëm i listave të kandidatëve që vendosen në ambientet për votim, si dhe material tjetër i nevojshëm për votim.

Procesverbalin e nënshkruajnë kryetari dhe anëtarët e këshillit zgjedhor dhe anëtari i këshillit komunal zgjedhor i cili e dorëzon materialin.

Nëse përfaqësuesit e pranishëm të dorëzuesve të listave kanë vërejtje për dorëzimin e materialit zgjedhor, ata kanë të drejtë t'u mundësohet të evidentohen në procesverbal dhe të jenë bazë në procedurën për mbrojtjen e të drejtës votuese.

Gjatë dorëzimit të materialit zgjedhor, të drejtë prezence kanë edhe vëzhguesit e autorizuar.

A. Petrovska

Çdo gjë që duhet të dini për Listën e Votuesve

Proceset zgjedhore në Republikën e Maqedonisë së Veriut çdo herë kanë tendencë të parregullsive që në pjesë të madhe janë të lidhura me Listën Zgjedhore, si lloj regjistri sipas të cilit udhëhiqet Komisioni Shtetëror Zgjedhor kur në ditën e zgjedhjeve përcakton se kush ka të drejtë vote. KSHZ është institucioni kompetent për azhurnimin e Listës së Votuesve.

Lista e Votuesve në Kodin Zgjedhor është e definuar si dokument publik për tërë territorin e shtetit mbi bazë të së cilës zbatohen zgjedhjet dhe referendimet në nivel shtetëror dhe lokal. Lista udhëhiqet sipas Regjistrit të shtetasve, në formë të regjistrit të votuesve me përpunim automatik të të dhënave. Kjo nënkupton se azhurnimin e Listës së Votuesve KSHZ e bën në bashkëpunim me organet tjera kompetente si MPB, MSHIA, organet gjyqësore, të cilat disponojnë me regjistra në baza të ndryshme.

Lista zgjedhore përmban të dhëna të qytetareve dhe qytetarëve që tregojnë se kanë mbushur 18 vite, kanë aftësi pune, vendbanim të vazhdueshëm në njësinë zgjedhore, komunë ose Qytetin e Shkupit ku bëhet zgjedhja. Sa u përket shtetasve të cilët në ditën e zgjedhjeve janë në punë të përkohshme ose qëndrim të përkohshëm jashtë vendit, ndërkohë që janë të regjistruar në Listën e Votuesve në bazë të evidencës nga organi kompetent ose paraqitjes për votim, kanë të drejtë vote për zgjedhje të presidentit të shtetit dhe zgjedhje të deputetëve në Kuvend në përfaqësitë diplomatike – konsullore në Maqedoni dhe jashtë vendit, gjegjësisht, zyre konsullore.

Ajo që është e rëndësishme për qytetarët është se KSHZ kryen regjistrimin, plotësimin dhe shlyerjen e të dhënave në Listën e Votuesve, në të shumtën e rasteve gjatë kontrollimit publik në Listën e Votuesve edhe pse sipas Kodit Zgjedhor kanë të drejtë gjatë tërë vitit të bëjnë kontrollin e të dhënave. Në parim, qytetarët vetë paraqiten në ndonjë nga repartet rajonale dhe në zyrat e KSHZ.

Për votuesit është e rëndësishme të dinë se KSHZ është kompetente sipas kodit Zgjedhor t'i mbrojë të dhënat nga Lista Zgjedhore, të cilat nuk guxojnë të përdoren për asnjë qëllim tjetër, përveç për realizimin e të drejtës votuese të qytetarëve. Ligji parashikon që partitë politike të regjistruara, koalicionet dhe

kandidatët e pavarur, gjegjësisht, përfaqësuesit e autorizuar dhe zëvendësit e tyre të dorëzuesve të listave të kandidatëve nuk mundën t'i shfrytëzojnë listat zgjedhore në ditën e zgjedhjeve për evidentimin e personave që kanë votuar.

Pikërisht kjo pjesë e Kodit Zgjedhor më shpesh shkelet në ditën e votimeve. Sipas përvojës së Civilit, çdo i treti vëzhgues paraqet evidencë të votuesve nga përfaqësuesit, zakonisht vëzhgues, të partive politike, brenda në vendvotim ose jashtë vendvotimit.

Problemi më i madh dhe parregullsitë më të mëdha me Listën e Votuesve ndodhin shumë më herët, pikërisht gjatë kontrollit publik. Atëherë, pjesa më e madhe e paraqitjeve të qytetarëve ka të bëjë me të ashtuquajturit votues fantazma.

Votuesit fantazma janë emra dhe mbiemra njerëzish që nuk ekzistojnë, asnjëherë nuk kanë ekzistuar ose nëse ekzistojnë, nuk dihet se ku gjenden, në adresën e votuesit të vazhdueshëm. Fantazmat nga institucionet përkatëse janë të shpjeguar si gabim sistemor, gabim i vetë qytetarëve të cilët nuk janë çlajmëruar nga venbanimi paraprak, manipulim i qëllimshëm me Listën e Votuesve nga pushteti, regjimi, struktura e kaluar të një institucioni të caktuar nga i cili KSHZ i merr të dhënat...

Megjithatë, edhe nëse është kështu, qytetarët zakonisht përballen me problemin e shlyerjes së këtyre votuesve fantazma nga Lista e Votuesve. Edhe pse KSHZ është kompetente për azhurnimin e Listës së Votuesve, kompetencat e saj janë vetëm për të dhënat personale të votuesve, por jo edhe të personave tjerë të cilët ndoshta jetojnë, e ndoshta edhe nuk jetojnë në adresën e njëjtë me votuesin që paraqet.

Prandaj, problemin më të madh në mbrojtjen e të drejtës votuese, votuesit a kanë qysh në fillim, me Listën e Votuesve, kur janë të detyruar ti zgjidhin vetë gabimet e institucioneve ose sistemit.

Në pjesën e evidentimit të së drejtës votuese në Kodin Zgjedhor, votuesit mund të njihen edhe më tepër me mënyrën e ankesave dhe afateve në rast të zgjidhjes negative në bazë të paraqitjes së tyre për regjistrim, shlyerje ose ndryshim të të dhënave në Listën e Votuesve.

B. Jordanovska

Çfarë është administratë zgjedhore

Çdo herë kur flasim për parregullsitë në proceset zgjedhore, e para në listën e zbatuesve është administrata zgjedhore.

Sipas definicionit, administrata zgjedhore përbëhet nga të punësuarit në shërbimin profesional të Komisionit Shtetëror Zgjedhor, anëtarët e organeve zgjedhore, sekretarët e komisioneve komunale zgjedhore, zëvendësit e tyre dhe persona tjerë, të angazhuar për procesin zgjedhor në trupat ndihmëse në Komisionin Shtetëror Zgjedhor. Këta janë njerëzit përgjegjës për rrjedhën e suksesshme për zbatimin e zgjedhjeve, dhe mënyrën se si në procesin do të respektohen përcaktimet ligjore, posaçërisht në mbrojtjen e të drejtës votuese.

Me shërbimin profesional të KSHZ udhëheq sekretari i përgjithshëm i cili është kompetent për të gjithë të punësuarit në KSHZ, me status të zyrtarëve shtetërorë.

Organet zgjedhore janë kompetente për zbatimin e veprimeve zgjedhore në ditën e votimit. Secili organ ka kryetarin e vet, anëtarët dhe zëvendësit e tyre.

Komisionet komunale zgjedhore kanë kompetenca në komunën në të cilën janë formuar, gjegjësisht, Qyteti i Shkupit, kur bëhet fjalë për zgjedhje lokale. Ato janë kompetentë për zbatimin e veprimeve zgjedhore në njësitë zgjedhore dhe vendvotimet ashtu si janë të përcaktuara me Kodin Zgjedhor.

Kryetarët, zëvendësit dhe anëtarët e Komisioneve komunale zgjidhen nga të punësuarit në administratën shtetërore, komunale dhe të Qytetit të Shkupit, me arsim sipëror, me zgjidhje rasti, gjatë pesë viteve. Kompetencat e tyre, mes tjerash, janë emërimi i përbërjes së këshillave zgjedhore, shkarkimin e anëtarëve të këshillave zgjedhore në rast të punës së tyre joligjore dhe ndërhyjnë në rastet kur konstatohet shkelje e ligjshmërisë së përgatitjeve, kandidimet dhe zbatimet dhe verifikimin e rezultateve të zgjedhjeve, si dhe të udhëzimeve dhe rekomandimeve nga Komisioni. Një nga funksionet e rëndësishme të Këshillave komunale zgjedhore, është informimi i votuesve për vendvotimin. Pra, nëse qytetarët dhe qytetarët nuk janë të sigurtë për vendvotimin, si dhe për çështje tjera lidhur me procesin zgjedhor dhe të drejtën e tyre votuese, mund të drejtohen në Komisionet komunale.

Komisionet komunale zgjedhore janë kompetente edhe për pranimin e mate-

rialit total nga këshillat zgjedhore, i mbledhin rezultatet nga votimi për listën e kandidatëve nga vendvotimet për të cilat janë përgjegjës, bëjnë transkripte dhe i dorëzojnë në KSHZ.

Këshillat zgjedhore janë të përbëra prej kryetarit dhe katër anëtarëve. Disa nga ata zgjidhen me zgjedhje rasti nga administrata zgjedhore, ndërsa nga një anëtar dhe zëvendës emërojnë partitë politike nga opozita të cilët në zgjedhjet e fundit për deputetë kanë fituar më tepër vota. Me rëndësi është të përmendet se personi i zgjedhur për anëtar të organit zgjedhor, ka të drejtë të mos pranojë ta kryejë atë detyrë, në rast të sëmundjes ose arsyeve familjare. Puna e tyre në ditën e votimeve ndahet në dy ndërrime që të munden ta realizojnë të drejtën votuese.

Detyrat e bordeve zgjedhore përbëhen nga zbatimi i votimit në vendvotime, sigurojnë rregull dhe fshehtësi të votimit, realizim të lirë dhe të qetë të votimit, e verifikojnë rezultatin e votimit në vendvotim, rezultatet nga votimi i publikojnë në vendin ku është zbatuar votimi.

Mirëpo, ky formalitet, me përshkrimin dhe kompetencat e administratës zgjedhore, nënkupton dhe bashkëpunim fluid mes të gjitha organeve nga maja, gjegjësisht KSHZ, deri te secili anëtar i këshillave zgjedhore.

Edhe vetë kryetari i KSHZ, Oliver Derkoski, në intervistë për CIVIL Media, deklaroi se hallka më e dobët e administratës zgjedhore janë pikërisht këshillat zgjedhore. Risia për zgjedhjet presidenciale 2019, është qasje e ndryshme edukative e anëtarëve të këshillave zgjedhore, por edhe shfrytëzimi mjeteve teknologjike që do ti aplikojnë këshillat zgjedhore, me çfarë do të shpejtëhet procesi i publikimit të rezultateve preliminare nga votimi.

B. Jordanovska

Çfarë është fushatë zgjedhore

“Fushata zgjedhore është paraqitje publike e kandidatëve të konfirmuar nga organet kompetente dhe programet e tyre në periudhën parazgjedhore për zgjedhje të caktuara”, thuhet në fjalorin në nenin 2 të Kodit Zgjedhor. Më tej, në nenin 69-a, Kodi më hollësisht e definon fushatën si:

“Tubim publik dhe ngjarje tjera publike nga ana e pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore, vendosja publike e pllakateve, video prezantimeve në vende publike, paraqitje mediatike zgjedhore dhe në internet, shpërndarje e materialeve të shtypura dhe paraqitje publike e kandidatëve të konfirmuar nga organet kompetente zgjedhore dhe programet e tyre”.

Sipas ligjit, fushata fillon 20 ditë para rrethit të parë të zgjedhjeve, që për zgjedhjet presidenciale do të thotë – nga 1 prilli. Më tej, në pjesën penale, ligji parasheh gjoba për shkelje të ndryshme të përcaktimeve të fushatës.

Atëherë, pse tre kandidatët presidencialë – Gordana Siljanovska Davkova, Stevo Pendarovski dhe Blerim Reka ka kohë që i filluan fushatat dhe i zbatojnë për çdo ditë?

Sepse, sipas ligjit të njëjtë, këto ende nuk janë fushata.

Fjala kyçe në definicionet e fushatës është përfaqësimi i kandidatëve të “konfirmuar. Ndërsa tre kandidatët tonë në fushatë kanë afat deri më 21 mars ta konfirmojnë kandidaturën e tyre në Komisionin Shtetëror Zgjedhor. Deri atëherë, siç e pranon KSHZ, por me siguri edhe deri në fillimin formal të fushatës parazgjedhore, fushatat e tyre janë “Takime partiake”.

Igor. K. Ilievski

Cilat janë autorizimet e Presidentit të Republikës

Komandanti suprem përmes ministrit për mbrojtje, ligjvënës përmes Kuvendit, emëruet i ambasadorëve me propozim të Qeverisë, nënshkruet i marrëveshjeve ndërkombëtare pas vendimit në referendum ose vendimit në Kuvend. Këto janë funksionet themelore të presidentit të shtetit, të përcaktuara në Kushtetutë dhe ligjet.

Në mënyrë të pavarur, presidenti mund të amnistojë, të dekorojë, të dërgojë deputet të posaçëm dhe të emërojë drejtor të Agjencisë për kundërzbulim dhe tre anëtarë të Këshillit për siguri, me të cilin kryeson. Mund të shpall edhe gjendje të jashtëzakonshme ose gjendje lufte, nëse Kuvendi nuk mund të kryesojë, por kur të mundet, duhet ta konfirmojë vendimin e tij. Mundet, me propozim të ministrit për kulturë, edhe të shpall artist nacional.

“Presidenti e përfaqëson Republikën. Presidenti është komandanti suprem forcave të armatosura”. Qëndron në Kushtetutë.

Presidenti, formalisht, ia jep mandatin mandatarit për përbërjen e Qeverisë, me dekret i emëron dhe i shkarkon ambasadorët dhe deputetët e shtetit jashtë vendit, gjeneralët dhe shëfën e Shtabit të Përgjithshëm të ARM, i pranon letrat akredituese dhe shkarkuese të përfaqësuesve diplomatikë të huaj.

Formalisht, presidenti i nënshkruan edhe dekretet për shpalljen e ligjeve. Por, si edhe pjesa më e madhe e ingerencave, edhe kjo është më tepër formale p nëse vendos të mos e nënshkruajë dekretin, është i obliguar ta nënshkruajë, nëse Kuvendi përsëri e voton ligjin. Për ligjet e sjella me shumicë, presidenti nuk ka të drejtë të mos e nënshkruajë dekretin.

“Në kornizat e kompetencave të Presidentit të Republikës është edhe të propozojë dy gjykatës Kushtetues, dy anëtarë të Këshillit Gjyqësor, dhe Këshillit të radiodifuzionit. Presidenti e propozon edhe guvernatorin e Bankës Popullore, të cilin pastaj e emëron Kuvendi”, thuhet në internet faqen e Presidentit.

Presidenti i Republikës gëzon imunitet, ndërsa pas mbarimit të funksionit, ai dhe familja e tij gëzojnë në të drejta të posaçme.

Igor. K. Ilievski

Çfarë është heshtje zgjedhore

Keqpërdorimi i resurseve publike është çdo keqpërdorim i mjeteve dhe të mirave në pronë të shtetit për qëllime zgjedhore. Kodi Zgjedhor është decid se nga dita e marrjes së vendimit për shpalljen e zgjedhjeve, deri në mbarimin e tyre, nuk mund të disponohet me mjetet e buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, nga fonde publike dhe mjete të ndërmarrjeve publike ose personave juridikë që disponojnë me kapital shtetëror të objekteve të reja në infrastrukturën siç janë rrugët, ujësjellësit, kanalizimet, çerdhet, shkollat, fushat sportive etj. Gjegjësisht, nuk mund të nisët ndërtimi.

Kjo nuk ka të bëjë me projektet për të cilat paraprakisht janë siguruar mjete nga buxheti, gjegjësisht, bëhet fjalë për realizimin e programit të sjellë në bazë të ligjit në vitin aktual.

Këtu në fakt edhe krijohet hutimi dhe mashtrimi më i madh, sepse, shpesh, sipas përvojave të deritanishme, këto projekte të cilat janë të parashikuara në programet, dhe për të cilat janë të miratuara mjete në vitin aktual, rregullohen në mënyrë që realizimi i tyre ndodh në kohën e periudhës parazgjedhore, ndër-sa u i shërben pushtetit të tregojnë se e realizojnë premtimin para qytetarëve.

Gjithashtu, në periudhën e dhënë, nga shpallja e zgjedhjeve deri në mbarimin e zgjedhjeve, nuk guxon të bëhet pagesa e rrogave, pensione, ndihmës sociale ose pagesa tjera dhe kompensime tjera nga mjetet e buxhetit, të cilat nuk janë pagesa të rregullta mujore. Të ndaluara janë edhe nënshkrimi marrëveshjeve kolektive.

Në periudhën prej 20 ditë para fillimit të fushatës zgjedhore, e deri në mbarim, nuk mund të paguhet subvencione, të cilat nuk janë pagesa mujore.

Gjithashtu, sipas Kodit Zgjedhor, në këtë periudhë nuk mund të mbahen ngjarje publike me rastin e fillimit të ndërtimit ose lëshimit në përdorim të objekteve me mjete nga buxheti, duke marrë parasysh se nën ndalesë për mbajtje të ngjarjeve publike nuk nënkuptohet dhënia e deklaratës nga bartës i funksionit publik, ose kandidatit për bartës të funksionit publik në tubime, intervistë në media, debat në media ose përgjigje në pyetje gazetareske.

Në periudhën e dhënë, Ministria për financa është e obliguar që të gjitha pagesat buxhetore, me përjashtim të rrogave të rregullta, pensione dhe harxhimeve komunale, t'i publikojë në internet faqe në bazë të veçantë për shpenzime buxhetore në periudhën zgjedhore. Ministria për financa, gjithashtu, dy javë pas shpalljes së zgjedhjeve është e obliguar të dorëzojë raport të veçantë financiar parazgjedhor, në të cilin do të përfshihet përmbajtja e të gjitha të

ardhurave dhe shpenzimeve të planifikuara dhe të realizuara nga buxheti, të ndara me artikuj, në periudhën nga fillimi i vitit fiskal deri në ditën e dorëzimit të raportit, i cili publikohet në ueb faqen e ministrisë.

Gjatë periudhës parazgjedhore dhe ditës zgjedhore, për nevojat e fushatës zgjedhore është i ndaluar shfrytëzimi i zyrave, pajisjeve dhe makinave zyrtare të organeve shtetërore, përveç personave për të cilët vlejnë rregulla të veçanta për mbrojtje, siç janë funksionarë shtetërorë të cilëve me këto rregulla u takon sigurim personal.

Për veprim në kundërshtim me përcaktimet e anëtarëve nga Kodi Zgjedhor të cilat kanë të bëjnë me këto çështje, nga ana e anëtari të Qeverisë, zëvendës ministër ose funksionar i cili udhëheq me organ, është e parashikuar gjobë me shumë prej 1000 deri 200 euro, në kundërvlerë në denarë.

M. Ivanovska

Çfarë është keqpërdorimi i pozitës zyrtare gjatë zgjedhjeve

Keqpërdorimi i pozitës zyrtare është çdo veprim i funksionarëve dhe personave zyrtarë me të cilin e shfrytëzojnë autorizimet e tyre, i tejkalojnë ose nuk e kryejnë detyrën zyrtare që të fitojnë ndonjë interes.

“Personi zyrtar i cili me shfrytëzimin e pozitës zyrtare ose autorizimin, me tejkalin e kufijve të autorizimit zyrtar ose me moskryerjen e detyrës zyrtare do të fitojë për vete ose dikë tjetër ndonjë interes ose i shkakton dëm tjetrit, do të ndëshkohet me burg prej 6 muaj deri 3 vite”, shkruan në Nenin 353 të Kodit penal Kaptina 13 – Vepra penale kundër detyrës zyrtare.

Në kontekst zgjedhor, keqpërdorimi i pozitës zyrtare nënkupton shfrytëzimin e pozitës së zyrtarit për qëllime zgjedhore. Për këto keqpërdorime shkruhet edhe në një kaptinë në Kodin penal, Kaptina 16 – Vepra penale kundër zgjedhjeve dhe votimit. Ky keqpërdorim i pozitës zyrtare shpesh ka të bëjë me ushtrimin e presionit ose tentimin për presion ndaj të punësuarve në administratën shtetërore publike, në institucione tjera të financuara nga buxheti i shtetit, buxhetet e komunave, si dhe në shoqatat tregtare dhe ndërmarrjet me kapital shtetëror.

Gjithashtu, keqpërdorimi i pozitës zyrtare për qëllime zgjedhore lidhet me kërcënime ndaj të punësuarve dhe qytetarë, në drejtim të punësimit të tyre dhe sigurisë sociale, si rezultat e mbështetjes së tyre ose mosmbështetjes së një partie politike ose kandidati të caktuar.

Pikërisht nga këto arsye, partitë politike dhe kandidatët pjesëmarrës në vendin janë të obliguar të nënshkruajnë Kodeksin për zgjedhje të drejta dhe demokratike me të cilin publikisht, pa dyshime obligohen se nuk do të kryejnë presione.

Keqpërdorimi i pozitës zyrtare mund të jetë edhe për persona zyrtarë që marrin pjesë në fushatë zgjedhore në uniformë zyrtare, për çfarë, për shembull, Kodi Zgjedhor parasheh gjobë në shumë prej 1000 deri 3000 euro në kundërvlerë në denarë.

M. Ivanovska

Çfarë është keqpërdorimi i resurseve publike për qëllime zgjedhore

Heshtja zgjedhore hyn në fuqi një ditë para zgjedhjeve (e shtunë), gjegjësisht, në mesnatë mes të premtes dhe të shtunës, kur mbaron fushata zgjedhore. Heshtja vazhdon deri në ora 19, në ditën e votimeve (e diel). Kjo nënkupton se propaganda, agjitimi partiak, ryshfeti i votuesve, fushata dhe shkelje tjera të Kodit Zgjedhor janë rreptësisht të ndaluara. Heshtja para Referendimit vazhdon 24 orë më gjatë.

Gjatë heshtjes zgjedhore informohet për zgjedhjet dhe rrjedhën e votimeve, por ndërpriten të gjitha format e paraqitjes zgjedhore mediatike.

Sipas Kodit Zgjedhor, si shkelje e heshtjes zgjedhore vlerësohet emetimi i informatave të çdo lloji, fotografive, materialeve audio dhe audio-vizuale lidhur me, ose të cilat kanë marrë pjesë në zgjedhjet, çdo formë të raportimit mediatik të cilat janë në funksion të hapur ose të fshehtë të ndonjë fushate zgjedhore dhe mund të ndikojnë mbi vendimet e votuesve, të dhëna me të cilat e zbulojnë identitetin e subjekteve politike dhe/ose të individëve të përfshirë në incidente ose parregullsi tjera në ditën e votimeve, si dhe paraqitje nga kandidatë në procesin zgjedhor, nga përfaqësues të partive politike dhe nga bartës të funksioneve në organet e pushtetit.

D. Muratov

Kërcënime dhe presione

Proceset zgjedhore në vend, çdo herë, me definicion, në sipërfaqe i hedhin të gjitha defektet e institucioneve, shoqërisë dhe shtetit. Mes tyre, pa përjashtime, çdo herë dhe çdo kund, janë kërcënimet dhe presionet politike, përmes ndarjeve, frikës dhe frikësimit, ndonjëherë pa turp, dhe ndonjëherë në mënyrë më delikate.

Kërcënimet dhe presionet zgjedhore janë keqpërdorim sistemor dhe presion mbi bazën politike qëllimi kryesor i të cilit është kontrolli mbi trupin votues. Sipas kësaj, shpesh në vete e përmbajnë edhe elementin e keqpërdorimit të detyrës zyrtare. Ose, më saktë, janë nënloje të kësaj kategorie. Viktimat më të shpeshta të kërcënimeve dhe presioneve politike janë qytetarët dhe qytetarët e punësuar në sektorin publik, por nuk përjashtohet edhe sektori privat.

Këto presione nuk janë të panjohura për shoqërinë tonë, dhe janë të intensifikuara në procese zgjedhore. SMS mesazhe për mobilizim, lista me “votues të sigurt”, largime nga puna, dënime... janë vetëm një pjesë e vargut të keqpërdorimeve përmes cilave bëhet propaganda e drejtpërdrejtë sistematike politike.

Në vitet e kaluara Civili si organizatë e cila zbaton monitorim gjithëpërfshirës dhe intensiv të proceseve zgjedhore në vend, shënon numër të madh të kërcënimeve dhe presioneve politike mbi të punësuarit në komunat, shkollat e mesme dhe fillore, çerdhet, ndërmarrjet komunale dhe publike. Por, të punësuarit në sektorin privat, kategoritë e rrezikuara sociale, si dhe vetë pronarët e kompanive private, shpesh përmes Drejtorisë për të ardhura publike. Ata më të guximshmit, politikisht të papërshtatshmit ose të padëgjueshmit, shpesh në fund përballen me dënime dhe largime nga puna, mosvazhdim të marrëveshjeve për punë, ulje të rrogave...

Çdo tentim për presion ose presion politik gjatë proceseve zgjedhore duhet të jetë i paraqitur dhe i sanksionuar përshtatshëm, vetëm në këtë mënyrë qytetarët dhe qytetarët do të marrin guximin ta realizojnë të drejtën e tyre për vendimmarrje politike. Vetëm në këtë mënyrë në vendin mund të zbatohen zgjedhje të lira që është parakusht për sundimin e shtetit juridik.

M. Ivanovska

Ryshfetin e votuesve e paguajnë vetë votuesit

E drejta e votimit nuk është privilegj. Është e drejtë të cilën askush nuk guxon ta marrë, as ta kufizojë ose manipulojë. Me të drejtën për votë askush nuk ka të drejtë të bëjë tregti ose ta kushtëzojë vullnetin e lirë të votuesve me shërbime, beneficione, para, siguri ose përfitime tjera, të drejta ose ndalesa... “, shkruan në “E drejta ime votuese”, publikimin edukativ të Civilit për forcimin e vetëdijes publike, edukimin dhe mobilizimin e qytetare/ëve për përmirësimin e proceseve zgjedhore që e definojnë qartë ryshfetin zgjedhor.

Më tej, në publikimin e njëjtë, organizata u drejtohet edhe drejtpërdrejtë votuesve: “Ti askujt nuk i ke borxh. Ryshfetin që ta ofrojnë, do të jetë shumëfish i paguar nga ti, nga familja jote dhe nga bashkëqytetarët dhe bashkëqytetarët!”

Ryshfeti i votuesve shpesh u drejtohet kategorive më të rrezikuara të qytetareve dhe qytetarëve. Të varfërit, ata që varen nga ndihma sociale, që nuk mund ti paguajnë llogaritë për rrymë dhe ujë, që nuk kanë as për bukë... Ata janë votuesit më të “lirë”, ndërsa ryshfeti për votat e tyre shpesh është nga 500 denarë për njeri. Por, shpesh kjo shumë zëvendësohet me një thes miell, kuti me pajisje për shtëpi, mjete për pastërti e shpesh edhe me pagesë të llogarive.

Ryshfeti i votuesve me intensitet më të madh ndodh në ditën e votimeve. Atëherë, trupi votues u nënshtrohet kërcënimeve, kushtëzimeve, vendeve të punës por edhe ryshfetit. Ryshfetin e bëjnë edhe ushtarë më të rëndomtë partiakë, por edhe funksionarë. Ky është një operacion i sofistikuar dhe i organizuar mirë që kushton shumë para. Ndërsa, ryshfetin e votuesve e paguajnë vetë votuesit.

B. Jordanovska

Përgjegjësia e mediave gjatë zgjedhjeve

Real dhe objektiv, i balancuar, i drejtë, i barabartë, i ndershëm dhe i pavarur, profesional, me komente të ndara nga informatat, tolerante, i lirë dhe përgjegjës. Këto janë fjalët kyçe për mënyrën në të cilën mediat duhet të informojnë në zgjedhjet, të mbledhura në përcaktimet e Kodit Zgjedhor, por edhe nga parimet e Konventës për informim etik për zgjedhjet në Këshillin për etikë në mediat në Maqedoni.

Pjesa e Kodit Zgjedhor që e definojnë sjelljen e mediave në procesin parazgjedhor mundet të jetë ligj. Gjashtë faqe nga “Kaptina 6 – Fushatë zgjedhore” kanë të bëjnë me obligimet e mediave gjatë fushatës zgjedhore, një faqe e tërë nga Fjalori i definojnë format e informimit në fushatë, ndërsa një hapësirë e madhe i dedikohet pjesës së përcaktimeve ndëshkuese në Kodin.

Kodi Zgjedhor i pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore ua garanton të drejtën edhe mediave të kenë qasje të barabartë dhe nën kushte të barabarta, dhe u jep mundësi të kërkojnë mbrojtje gjyqësore nëse u lëndohet kjo e drejtë. Kodi i lidh mediat ti mbulojnë fushatat “në mënyrë të drejtë, të balancuar dhe të paanshme”. Mediat dhe të punësuarit e tyre nuk guxojnë të financojnë ose të dhurojnë te partitë politike.

“Redaktorë, gazetarë, moderatorë të programeve dhe prezantues, të angazhuar në përgatitjen e programeve të radiodifuzorëve, nuk guxojnë të marrin pjesë në aktivitetet parazgjedhore të partive politike, grupeve të votuesve ose përfaqësuesve të tyre, gjegjësisht, pjesëmarrësve në fushatë zgjedhore. Nëse përcaktohen të marrin pjesë në aktivitete të tilla, angazhohet i tyre në programet e radiodifuzorëve u pushon nga dita e shpalljes së zgjedhjeve deri në mbarimin e tyre”, thuhet në Nenin 75 -v të Kodit.

Për aktivitetet e rregullta të organeve shtetërore dhe ndërmarrjeve publike nuk guxon të informohet si për fushatë zgjedhore, ndërsa deri në fund të zgjedhjeve mediet nuk guxojnë të publikojnë reklama të paguara me para nga

buxheti. Reklamimi i paguar politik duhet të shënohet dukshëm, si dhe porositësi i reklamimit. Duhet të publikohet edhe emri i porositësit, si dhe parametrat themelore, edhe të anketimeve të opinionit publik që do të publikohen në fushatën parazgjedhore.

Programet e dedikuara për publiken minore nuk guxojnë të shfrytëzohen për përfaqësim zgjedhore mediatik, ndërsa minorët nuk guxojnë të marrin pjesë as në reklamimin e paguar politik.

I. K. Ilievski

KSHZ e publikoi programin për edukim dhe informim të votuesve

Para zgjedhjeve presidenciale, të mësuar nga kritikrat në proceset zgjedhore të kaluara, Komisioni Shtetëror Zgjedhor ka vendosur të përgatisë programe të detajuar për edukim dhe informim të votuesve. Qëllimi i këtij programi është që KSHZ para së gjithash përmes tij të punojë në drejtim të forcimit të vetëdijes dhe njohuritë e qytetarëve për procesin zgjedhor. Praktika deri tani ka treguar se, edhe pse KSHZ, si institucion kompetent për zbatimin e zgjedhjeve ka përgjegjësi votuesit të jenë të informuar mirë dhe të edukohen, qytetarët çdo herë mbeten të lënë pas dore, në llogari të edukimit të administratës zgjedhore. Për fat të keq, praktika tregon se edhe në mënyrë të vazhdueshme, në çdo proces zgjedhor, përballemi me administratë të painformuar dhe të paedukuar, panjohuria e të cilës rezulton me shumë parregullsi zgjedhore.

Edukimi i qytetarëve është prioritet strategjik i KSHZ për periudhën 2017 – 2020, me mundësi për përgatitje të programeve të reja, me përdorim të teknikave të reja dhe metodave të edukimit të qytetarëve dhe votuesve.

Si vërejtje pozitive është krijimi i një programi i dedikuar qytetarëve për të drejtën e tyre votuese, dhe jo vetëm program i detyrueshëm për këshillat zgjedhore, të cilat si zakonisht nuk ishin efikase.

Ajo për të cilën KSHZ, sipas rregullave, duhet t'i informojë qytetarët, e deri tani nuk arritën, është, se kush ka të drejtë vote, kur dhe ku votohet, çfarë nevojitet për realizimin e të drejtës votuese, çfarë është e ndaluar në vendvotimet, si votohet, në cilën mënyrë votohet dhe si dorëzohen ankesa për mbrojtjen e të drejtës votuese.

Programi i tërësishëm parashikon edhe fushatë mediatike, mjete për marrëdhënie me publikun, si dhe azhurnimin e rregullt të Listës së Votuesve.

Në fund, siç shkruan në programin, qëllimi është të fitohet përshtypja se

KSHZ kujdeset për votuesit dhe të kthehet besimi i qytetarëve në këtë institucion.

Mesazhet kryesore të KSHZ janë: Komisioni Shtetëror Zgjedhor i merr të gjitha veprimet e domosdoshme në drejtim të zbatimit të zgjedhjeve presidenciale të drejta dhe demokratike, secili mund ta shfrytëzojë në pajtim me bindjet personale, askush nuk guxon dhe nuk mundet ta keqpërdorë të drejtën votuese, KSHZ do t'i sigurojë parimet e barazisë, paanshmërisë dhe ligjshmërisë të zgjedhjeve presidenciale.

Mbetet të shihet se sa nga këto qëllime të KSHZ me të vërtetë do të realizohen, dhe çfarë do të mbetet vetëm në letër.

Pjesa edukative dhe informative për votuesit, si dhe fushata zgjedhore, sipas programit, do të fillojë paralelisht me fushatën e kandidatëve për president, gjegjësisht, më 1 prill.

B. Jordanovska

Vizioni dhe misioni i CIVILit

(Fragment nga Statuti i Civilit)

VIZIONI DHE MISIONI

Neni 1

CIVIL – Qendra për Liri (në tekstin e mëtutjeshëm vetëm Civili) është shoqatë joprotabile e qytetarëve, e formuar me bashkim të lirë për shkak të realizimit të misionit në interesin shoqëror.

Neni 2

Vizioni i Civilit është për një botë në të cilën të gjithë njerëzit jetojnë në shoqëri të qetë demokratike në të cilën:

të drejtat dhe liritë e njeriut respektohen plotësisht;
nuk ka dhunë dhe kulti ndaj armëve është i tejkaluar;
nuk ka diskriminim dhe shovinizëm në cilën do formë;
sundon liria e plotë e shprehjes dhe mediat janë të lira dhe të pavarura nga ndikimi i qendrave të fuqisë;
institucionet janë të pavarura dhe tërësisht të përkushtuara ndaj interesave të qytetarëve dhe qytetarëve;
zgjedhjet janë të drejta dhe demokratike, ndërsa qytetarët dhe qytetarët të papenguar organizojnë dhe marrin pjesë në proceset e vendimmarjeve; kultura dhe arti janë pjesë përbërëse e përditshmërisë së shoqërisë;
ekologjia dhe mbrojtja e mjedisit jetësor janë kriteriume për zhvillim. Qëndrimet e lartëpërmendura praktikohen në formë të pandarë.

Neni 3

Në kërkim të vizionit, misioni i Civilit është:

të zbatojë edukim aktiv, promovim dhe mbrojtje të të drejtave dhe lirive të njeriut;
të jep kontribut aktiv ndaj paqes së qëndrueshme dhe ndaj proceseve për pajtim;
të zbatojë aksione për prevenim nga konfliktet, kontrollin efektiv të armëve dhe tejkalimin e kultit ndaj armëve;
të zbatojë edukim aktiv, promovim dhe mbrojtjen e lirisë së shprehjes;
të jep kontribut aktiv ndaj zhvillimit të mediave të lira dhe të pavarura;
të zbatojë strategji dinamike për kulturë dhe art;
të iniciojë ose të mbështesë procese lokale, nacionale, rajonale dhe globale për paqe dhe stabilizim, zgjidhje të padhunshme të konflikteve, të drejtave të njeriut dhe demokracisë përmes marrëdhënieve me opinionin dhe anëtarësisë në asociacione dhe struktura nacionale, rajonale dhe ndërkombëtare;
të jep kontributin aktiv ndaj integritetit të ekologjisë në strategjitë zhvillimore në të gjitha nivelet.

VLERAT THEMELORE

Neni 4

Në Civil, të gjithë anëtarët e ekipeve të projekteve, vëzhguesve dhe ekipeve tjera, dhe bashkëpunuesit, punojnë së bashku në arritjen e vizionit dhe misionit të tyre, përmes aksionit të vazhdueshëm dhe efektiv të bazuar në respektin e plotë të të drejtave të njeriut, universalitetin dhe pandashmërinë e tyre, si dhe në solidaritetin, barazinë, paanshmërinë, demokracinë dhe respektin e ndërsjellë. Secili person, në relacion me Civilin pajtohet me vizionin e dhe misionin e Civilit dhe do të angazhohet për vlerat themelore në jetën e vet private dhe profesionale. Deklarata universale e të drejtave të njeriut konsiderohet si pjesë përbërëse e këtij Statuti. METODAT

Neni 5

Civili kërkon nga strukturat që sjellin vendime në nivel lokal, nacional dhe ndërkombëtar, nga Qeveria, institucionet relevante, organizatat ndërqeveritare, grupacionet e armatosura dhe politike, kompanitë dhe aktorët tjerë joqeveritarë, t'i hapin temat prekëse në shoqëri dhe në komunitetet, dhe të punojnë bashkë me qytetaret dhe qytetarët në pajtim me vizionin, misionin dhe programin e Civilit.

Neni 6

Civili i hulumton faktet dhe modalitetet e keqpërdorimeve të ndryshme në shoqëri dhe institucionet në mënyrë thelbësore dhe i publikon gjetjet dhe qëndrimet e veta. Trupat e ndryshme të Civilit, anëtarët, mbështetësit dhe

personeli e mobilizojnë presionin publik ndaj Qeverisë dhe institucioneve në nivel lokal dhe nacional, që t'i korrigojnë politikat dhe praktikatat e tyre, ndërsa keqpërdorimet t'i ndalojnë me vendosmëri dhe t'i sanksionojnë.

Neni 7

Civili ndikon mbi Qeverinë, Parlamentin, institucionet dhe qendrat tjera të fuqisë, në nivel lokal dhe nacional, të jenë të përgjegjshëm dhe transparent dhe t'u përmbahen parimeve të sundimit të drejtësisë, demokracisë dhe të drejtave dhe lirive të njeriut.

Neni 8

Civili zbaton gamë të gjerë të aktiviteteve në domenin e vetëdijes publike, edukimin, lobimin dhe përfshirjen.

Civili i vëzhgon, analizon dhe jep rekomandime për politika dhe praktika në sferën e zgjedhjeve, legjislativën zgjedhore dhe proceset zgjedhore.

Neni 9

Civili i inkurajon organizatat ndërqeveritare dhe joqeveritare, individët dhe të gjitha pjesët e shoqërisë t'i mbështesin, respektojnë dhe të punojnë për interesin e të drejtave dhe lirive të njeriut, paqen dhe shoqërinë pa armë dhe dhunë.

Neni 10

Civili do t'i realizojë qëllimet e veta dhe veprimet programore në pajtim me Kushtetutën e RM dhe me këtë Statut, si dhe me norma tjera ligjore dhe standarde ndërkombëtare të cilat e rregullojnë materien e kësaj fushe.



ÇDO GJË QË
DESHËT TË
DINI PËR
ZGJEDHJET

PARAQIT PARREGULLSI
www.slobodniizbori.info
02 / 520 91 76
monitoring.civil@gmail.com

ISBN-10
ISBN-13
EAN

608-4815-25-1
978-608-4815-25-9
9786084815259